




**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**STUDIM I TREGUT TË PUNËS
PËR STUDENTËT E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA ME
KËNDVËSHTRIMIN PËR GUIDA TË TURISTËVE**

Tiranë, Mars 2024



Ky studim u hartua në kuadër të projektit fitues: “*Studim dhe analizë mbi koherencën dhe standardet e pritshme të specialistëve gjuhësorë në fushën e turizmit në kontekstin shqiptar*”, të financuar nga Universiteti i Tiranës në programin “UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION”.

Autorë të këtij punimi janë:

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha, Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës dhe anëtare e grupit të punës së projektit;

Dr. Drita Rira, Zv. Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës për ciklin e dytë të studimeve, Koordinatore akademike Erasmus+ dhe Marrëdhënieve me Jashtë si edhe lektore e studiuese në gjuhën frënge në disiplina që lidhen me çështje të terminologjisë së marrëdhënieve ndërkombëtare, organizatave ndërkombëtare, leksikut të politikës, përkthimit dhe interpretimit, komunikimit turistik.

Vasilika Mulla anëtare e grupit të punës së projektit dhe Përgjegjëse e Degës së Projekteve, në Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.

Tiranë, Mars 2024

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	2
2.	Metodat e përdorura për studimin e tregut.....	2
3.	Të dhëna të përgjithëshme mbi turizmin.....	4
4.	Të dhëna indirekte.....	8
5.	Tregu i punës në sektorin e turizmit.....	11
5.1.	Pyetësor dhe konkluzione me agjencitë dhe operatorët turistikë vendas.....	13
5.2.	Ofruesit e arsimit mbi turizmin.....	15
6.	Pyetësor dhe konkluzione me studentët e diplomuar në FGJH.....	17
6.1.	Organizimi dhe metodologjia.....	17
6.2.	Pyetësi ndaj studentëve të diplomuar në FGJH.....	18
7.	Konkluzione mbi studimin e kryer.....	36
8.	Bibliografia.....	42



1. Hyrje

Shqipëria është nga ato vende, që vitet e fundit e kanë hedhur vëmendjen nga sektori i turizmit, si një nga sektorët më të fuqishëm ekonomik, duke qenë se edhe kushtet natyrore e favorizojnë shumë. Vendi ofron detin, malin, fushën, luginën, lumenjtë, lagunat, pyjet etj. të cilat mund të vizitohen brenda një kohe të shkurtër dhe duke ja bërë më të lehtë turistit për t'i shijuar të gjitha së bashku. Mirëpo, trajtimi i turizmit me cilësi kërkon forca të kualifikuara, ndaj dhe si imperativ i kohës del që edhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të ridimensionojë produktin e tij në bazë me kërkesat e tregut të punës dhe me segmentet që ai mund të ofrojë në një kohë të shkurtër por edhe sa më cilësore.

Një studim mbi tregun e sotshëm sjell me vete dhe kërkesat se cilët segmente në rritje kanë nevojë urgjente për personel të kompletuar. Sipas Agjencisë Telegrafike Shqiptare në periudhën janar-qershor 2022 Shqipëria u vizitua nga 2.5 mio vizitorë ndërsa në periudhën janar-qershor 2023 nga 3.4 mio vizitorë ose 33% më shumë. Kryeministri në ditët e fundit është shprehur se vetëm gjatë muajit gusht 2023 janë futur 2 milion vizitorë. Pra pritet që vitin e ardhshëm edhe sikur ky ritëm të ruhet do të ketë një kërkesë të madhe në këtë fushë për guida turistike.

Studimi periodik i dinamikës së tregut të punës përbën një domosdoshmëri për përcaktimin sa më të drejtë të strategjisë së zhvillimit të programeve të studimit në të gjitha ciklet. Nevoja e kryerjes së këtij studimi lidhet me dinamikën e ndryshimeve strukturore që përjeton tregu i punës në Shqipëri, si reflektim i modernizimit të strukturës së ekonomisë dhe i ndërkombëtarizimit të studimeve dhe të marrëdhënieve të punës.

Qëllimi i studimit të tregut është fillimisht ndërtimi i një vizioni të qartë në lidhje me ofertën ekzistuese në treg të formimeve me karakter kulturor e gjuhësor, me qëllim që të përcaktohet mjedisi konkurrues, të shënjestrohen ofertat e ndryshme që gjenden në treg si edhe të hetohen nga afër tendencat e tregut të cilat mbështesin nevojën e hapjes së formimeve të reja.

2. Metodatat e përdorura për studimin e tregut

Qasjet e përdorura për studimin e tregut janë:

1. Analizë e të dhënave statistikore për tregun e punës në sektorin përkatës;
2. Statistika marrë sipas burimeve zyrtare për punësimin e përkthyesve për tekste turistike në tregun vendas;
3. Pyetësor me aktoret kryesore (agjencitë dhe operatorët) turistike vendas;
4. Të dhëna të tregut për ofruesit në fushën e turizmit;
5. Pyetësor me studentët e diplomuar nga FGJH;
6. Analizë e të dhënave statistikore sipas burimeve zyrtare, për tregun e punës në sektorin e turizmit

Puna për studimin e tregut u organizua në këto faza:

Faza e parë: Njohja dhe përcaktimi i burimeve statistikore që ofrohen nga Universiteti i Tiranës, INSTAT, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Departamenti i Administratës Publike, etj, si edhe njohja me studime të ngjashme të kryera nga institucione të tjera kombëtare apo ndërkombëtare.

Faza e dytë: Hartimi i pyetësorit për Agjencitë dhe Operatorët Turistikë vendas, për të marrë informacion mbi punësimin e studentëve të diplomuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, si dhe nevojat e ofruesve të punësimit për profilin e të punësuarit. Gjithashtu sigurimi i të dhënave mbi aktorë të tjerë të punësimit si Agjenci Turistike dhe Shtëpi Botuese vendase. Organizimi i shpërndarjes së pyetësorit, me synim arritjen e një numri sa më të madh të agjencive turistike, u bë duke i kontaktuar direkt këta operatorë. Si kontakte u shfrytëzuan të dhënat e ofruara nga web.

Faza e tretë: Hartimi i pyetësorit për studentët, që kanë mbaruar studimet në programet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në katër vitet e fundit, me qëllim tërheqjen e mendimit dhe përvojave të tyre në punësim. Organizimi i shpërndarjes së pyetësorit me synim arritjeje një numri sa më të madh studentësh të diplomuar vitet e fundit u bë nëpërmjet platformës online. Për studentet u shfrytëzuan kontaktet që disponojnë Sekretariatë Mësimore dhe Departamentet.

Faza e katërt: Përpunimi tabelar e grafik i të dhënave të pyetësorëve. Interpretimi dhe analiza e tyre.

Faza e pestë: Evidentimi i përfundimeve dhe rekomandimeve.

Ky studim shërben si orientues për të gjykuar mbi prirjet e fundit të kërkesë-ofertës në tregun e punës për të sapodiplomuarit. Gjithashtu ky punim synon të sjellë një analizë komplekse të impakteve sociale të reformave në arsimin e lartë dhe nevojave për ta përshtatur ofertën që sjell arsimi i lartë me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri.

Pjesën më të rëndësishme të punimit e përbëjnë gjetjet e pyetësorit të organizuar nga grupi i punës në të cilin janë analizuar një sërë aspektesh që kanë të bëjnë me vështirësitë në gjetjen e një pune, rolin e cilësisë së programeve të FGJH-së në lehtësimin e gjetjes së një pune, shpërndarjen gjeografike të punësimit, sektorët ku punësohen më së shumti studentët, përshtatjen e aftësive që fitohen nga programet mësimore të ofruara nga FGJH me kërkesat e tregut të punës, promotorët në gjetjen e një pune dhe ndihmën që duhet të japë Universiteti, roli i praktikave mësimore e profesionale, etj. Interpretimi i të dhënave të pyetësorit është shoqëruar me aparatën e nevojshëm tabelar e grafik për t'i bërë më të lexueshme gjetjet që rezultojnë prej tij.

3. Të dhëna të përgjithëshme mbi turizmin

Qëllimi kryesor për të cilët kontribuojnë programet e ofruara në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, janë ato në përgatitjen e Mësuesve të Gjuhës së Huaj për Arsimin e Mesëm të Lartë, në gjuhën përkatëse sipas çdo Departamenti. Për të siguruar të dhëna, lidhur mbi punësimin aktual të mësuesve të gjuhëve të huaja, të cilët janë diplomuar në FGJH, iu referuam të dhënave të siguruar nga burime të diversifikuara.

Lidhur me të dhënat e të punësuarve në guida kombëtare, rezulton se nëpërmjet portalit të pafreskuar të Ministrisë së Turizmit deri në vitin 2022¹ për guidat paraqitet statistikë me afro 224 guida me të dhëna të detajuara me gjuhët përkatëse që përdorin. Nga analiza e këtyre të dhënave del se gjysma e numrit të guidave janë me dy gjuhë. Ndërsa për vitin 2020² nga i njëjti burim të dhënash guida kombëtare të regjistruara kanë qënë afro 180. Për vitin 2020 lista e ministrisë ka të regjistruar rreth 70 guida lokale.

Të dhënat zyrtare më sipër janë në rang republike, por realisht ky numër i të punësuarve është shumë më i lartë sepse egzistojnë edhe personat që punojnë në zyra si edhe ciceronët, tourliderat apo edhe guidat e palicensuara (afërsisht 1/2) krahasuar me të licensuarit.

Duke analizuar kërkesën gjithmonë në rritje si për hotelet ende të pahapura në sektorin e recepsionit apo edhe faktin e bomit të turizmit për vitin 2023 si edhe kërkesën në rritje për fletëpalosje turistike apo edhe situatën globale në rritje të industrisë së turizmit kemi një panoramë më të qartë.

Një aspekt tjetër i pa llogariur në asnjë statistikë është kërkesa për tourlider, pra për shoqërues të grupeve shqiptare që dalin në vende të tjera dhe kanë nevojë si për përkthyes ashtu edhe për koordinator dhe pjesërisht edhe guidë.

Vërehet se statistikat e dhënat janë kryesisht për guida, ndërkohë që sektori i ciceronëve në gjuhë të huaja është i paregjistruar askund.

Nëse analizojmë vetëm Muzeun Historik Kombëtar, mendohet që për pesë gjuhët e mëdha duhet të ketë dy ciceronë për secilën gjuhë dhe atëherë shifra shkon në 10 ciceronë vetëm në një muze në qytetin e Tiranës, pa përmendur sitet arkeologjike si Shkodra me kalanë dhe dy muzetë e saj: ai arkeologjik dhe i fotografisë, Apollonia, Durrësi me muzeun dhe amfiteatërin, Berati me kalanë dhe muzeun ikonografik, Butrinti apo dhe ndonjë sit tjetër që ka muze me frekuentim

¹ <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Lista-e-udh%C3%ABrr%C3%ABfyesve-kategoria-KOMBETAR.pdf>

² <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/Lista-e-udh%C3%ABrr%C3%ABfyesve-kategoria-LOKAL.pdf>

tepër të lartë si psh.: Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar (Muzeu i Ikonave) në Korçë apo Bunkart në Tiranë, Kruja me Muzeun Kombëtar Gjergj Kastrioti dhe Muzeun Etnografik, Gjirokastra kala plus Muzeun Etnografik, pa numëruar këtu edhe muzetë e tjerë etnografik në qytete të tjera ende të papromovuara. Me një mesatare 1 (një) ciceron për çdo muze përmendur më lart apo të tjerë site që ende nuk janë promovuar si Parku Arkeologjik Bylis, etj. Për një turizëm në rritje numri i ciceronëve është thujtë në krizë dhe kanë nevojë urgjente për personel të kompletuar. Të gjithë vendet turistike më sipër llogaritet të paguhën nga sektori publik, pra nuk duhen ngatërruar gudiat me terminologjinë shqipe “udhërrëfyes i turistëve”, me termin shpesh gabim “udhërrëfyes turistik”.

Në këtë rast do të duhej të verifikohet se sa ciceronë janë në organikë dhe sa prej tyre janë me gjuhë të huaj të dëshmuar/certifikuar me provimin për gjuhën e huaj që përdorin. Por e ardhmja flet që të gjithë këto vende pune do të duhet të zihen ndoshta me kuadro që vijnë nga dega e Historisë e Gjeografisë të cilët detyrimisht në bazë të ligjit do të duhet gjithashtu të dëshmojnë gjuhën e huaj në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

Për sa i përket nivelit të gjuhëve të veçanta, ka dalë një nevojë aq e ngutshme saqë kanë filluar të licensohen edhe shtetas të huaj (të cilët shpesh nuk kanë njohuri të thella të kulturës shqiptare, pa përmendur njohuritë mbi gjuhën shqipe).

Duke qënë se institucionet e arsimit të lartë që merren me turizmin ndodhen përpara sfidave të mëdha të mbylljes së sektoreve të menaxhimit të agjencive apo edhe të hoteleve, që sërisht po njohin një bum Shqipëri, gjendja ngjan që është tepër urgjente për strukturim drejt tregut turistik dhe duke mos harruar që jetojmë në një trekëndësh vendesh turistike me potencial të madh si psh Kroacia, Greqi dhe Italia, pra një kalim tre ditësh përmes Shqipërisë e bën më të qartë këtë imperativ.

Nga një vështrim më i detajuar nga e përditshmja konstatojmë se të gjithë sektorët e sipërpërmendur nuk kërkojnë më vetëm shërbim në një nga gjuhët e mëdha, por edhe disa gjuhë që ende nuk janë prezente në programet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Nëse krahasojmë punësimin në të dy sektorët, atë publik dhe privat, sigurisht që pjesën më të madhe e zënë te punësuarit në sektorin privat. Ndërkohë vëmë re nga kjo analizë të dhënash, se në sektorin privat gjuhët me kërkesë më të lartë janë gjuha angleze, italiane, spanjolle, gjermane, frënge dhe polake apo edhe arabe kurse në sektorin publik kërkesa ka këtë rradhë preference, gjuha angleze, italiane, gjermane dhe frënge. Mangësi të mëdha në sektorin privat për guidat ndjehen për gjuhët serbo-kroate, bullgare, hungareze dhe ukrainase.

Një front tjetër punësimi i studentëve që diplomohen në FGJH është edhe punësimi sezonal. Nuk duhet lënë mënjanë fakti që se gjatë sezonit të verës shumë sektorë kërkojnë forca punëtore me

gjuhë të huaja dhe më njohuri të përgjithshme turistike (kujtojmë se gjatë verës kërkohen edhe policë me gjuhët kryesore të mëdha të cilët mund të orientojnë turistët).

Sektori i turizmit zë një pjesë të konsiderueshme të ekonomisë në shumë vende evropiane. Nisur nga potenciali i sektorit në aspektin e rritjes dhe punësimit por edhe në aspektin social dhe integritimit kulturor, çdo vlerësim i konkurrencës dhe pozicionit të tij kërkon një njohje të mirë nëpërmjet statistikave zyrtare të vëllimit të turizmit, karakteristikave të turizmit udhëtimet, profilin e turistit, shpenzimet turistike dhe përfitimet për ekonominë e shtetit.

Raporti zyrtar nga INSTAT mbi Anketën e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” publikuar me nëntor 2022 ku të dhënat mbi Turizmin të cilat janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.

Informacioni statistikor mbi turizmin është mbledhur bazuar në anketimin e individëve. Mbledhja e të dhënave bazohet në një intervistë të drejtpërdrejtë përmes intervistuesve. Për mbledhjen e të dhënave përdoret metoda PAPI.

Tabela A1 – Shpërndarja e udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë

Viti 2021	Vlerësimi i nr të udhëtimeve	%
Në Shqipëri	3 122 456	90%
Jashtë Shqipërisë	337 043	10%
Gjithsej	3 459 499	

Tabela A2 - Shpërndarja e udhëtimeve sipas llojit të tyre

Viti 2021	Vlerësimi i nr të udhëtimeve	%
Për qëllime personale	3 358 910	97%
Për qëllime biznesi	100 589	3%
Gjithsej	3 459 499	




Vendi ka investuar në infrastrukturën e tij turistike, duke përfshirë hotelet, transportin dhe shërbimet, për të akomoduar numrin në rritje të turistëve.

Tashme pas pandemisë së COVID-19, Shqipëria ka promovuar vendin në mënyrë aktive si një destinacion turistik dhe me bukurinë e saj natyrore dhe atraksionet historike, gjë që do ndikojë në tërheqjen e vazhdueshme të vizitorëve edhe në vitet e ardhshme duke patur një vizion të qartë mbi perspektivat e së ardhmes.

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar në muajin Gusht 2023 janë 2,861,545. Ky tregues rezulton me një rritje 16,9%, krahasuar me muajin Gusht 2022. Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Gusht 2023 janë 3,014,747 duke shënuar një rritje me 20.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Në Gusht 2023, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 838,791. Ky numër është rritur me 13.7% krahasuar me muajin Gusht 2022. Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 2,022,754. Ky numër është rritur me 18.3%, krahasuar me muajin Gusht 2022. Gjatë tetëmujorit 2023, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 7,190,410. Ky numër është rritur me 26.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 (fig.1).



Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Gusht 2022- Gusht 2023



Turizmi në Shqipëri tashmë është afirmuar si një destinacion i preferuar në Ballkanin Perëndimor duke shënuar rritje kolosale të numrit të turistëve në verën e vitit 2023 krahasuar me vitet e

mëparshme. Më poshtë deklarime publike edhe të Kryeministrit të Shqipërisë në rrjetet e tij sociale:

 Shqipëria "e preferuara e re" e Ballkanit është kthyer tashmë një pol tërheqës edhe për vizitorët turq duke thyer një rekord turistik, siç thotë në këtë artikull promovues media e njohur "Haber Turk" 

 132% më shumë vizitorë nga Turqia frekuentuan vendin tonë deri në muajin gusht, krahasuar me një vit më parë, një surprizë, por edhe një garanci që Shqipëria ka afirmuar vendin e saj mes vendeve fqinje, prej dekadash të konsoliduara në industrinë e turizmit 

Në këtë studim egzistojnë edhe të dhëna për përkthyesit dhe të dhëna të tjera, kjo është edhe brend suazës që edhe nga profesioni i mësuesit edhe nga i përkthyesit, porë nga këndvështrimi që turizmi shqiptar pikun e tij e ka në sezonin e vërës, kjo mund të përshatet edhe me kohën e pushimeve të mësimdhënësve. Përsa u përket përkthyesve nuk ka dhe nuk mund të ketë turizëm serioz pa programe të shkruara mirë dhe shkruar me informacione të freskuara të kurrikulave bashkëkohore.

4. Të dhëna indirekte

Për sigurimin e statistikave, lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar nga FGJH, kryesisht për ata të degës së përkthimit, drejtuam një pyetësor të thjeshtuar ndaj Agjencive të Përkthimit dhe Shtëpive Botuese.

Nga kontakti me ta, rezulton se të gjitha Agjencitë e Përkthimit (100% e agjencive të pyetura) kanë të punësuar më shumë se një përkthyes të diplomuar në FGJH. Përkthyesit e punësuar janë në pjesën më të madhe të diplomuar në gjuhën angleze (65% e numrit të përkthyesve të punësuar në agjencitë e intervistuar), 13% e tyre të diplomuar në gjuhën gjermane, 13% të diplomuar në gjuhën italiane dhe 12% e numrit të përkthyesve të punësuar në agjencitë e intervistuar janë në gjuhën greke.

Ajo që vihet re nga kontakti me agjencitë e përkthimit është interesi që këto agjenci shprehin për të krijuar apo zgjeruar bashkëpunimin me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, lidhur me praktikat profesionale të studenteve, që janë duke u diplomuar si përkthyes të rinj. Interesi i treguar është edhe për përkthyes në gjuhët më të rralla si rusisht, bullgarisht.

Ndërkohë nga kontakti i kryer me Shtëpitë Botuese, vihet re se marrëdhënia e punësimit që ata preferojnë të mbajnë me përkthyesit është angazhimi i punësimit me kohë të pjesshme. Ndryshe nga interesi që shfaqnin agjencitë e përkthimit ndaj përkthyesve të rinj, Shtëpitë Botuese kanë

3

<https://www.facebook.com/ediramaal/posts/pfbid02d9QuWjPa2ftuNYnbrCuC4K8FrMtzJGBP5a2Q8NCYNuTTfZ6yT5qeR4pt1suteUhTl>

kërkesë për angazhimin me punë të përkthyesve të afirmuar. Botuesit punojnë kryesisht me përkthyes të certifikuar ose profesorë të gjuhëve përkatëse.

Të dhëna mbi përkthyesit e afirmuar në vendin tonë për secilën gjuhë, marrë nga Ministria e Drejtësisë e cila publikon në faqen e saj web çdo vit⁴ Listën e përkthyesve të jashtëm me certifikatë sigurie dha pa certifikatë, të cilët janë përkthyes me eksperiencë të gjatë në fushën e përkthimit, si edhe atë akademike.

Për një panoramë më të qartë të numrit të përkthyesve të afirmuar dhe të regjistruar si të tillë në vendin tonë, duke përdorur si burim të dhënash listën e publikuar me dt. 01.12.2020, shohim tabelën si më poshtë:

Numri i përkthyesve të afirmuar

Gjuha	Me certifikatë sigurie	Pa certifikatë sigurie
Angleze	85	261
Italiane	68	168
Gjermane	7	45
Frënge	20	59
Greke	15	65
Spanjolle	10	11
Turke	3	33
Polake	2	7
Ruse	2	16
Rumune	6	11
Maqedonase	3	3
Serbe/Kroate/ Malazeze /Boshnjake	2	
Bullgare	2	12
Hollandeze	2	0
Arabe	1	6
Portugeze	1	0

⁴ <https://www.drejtësia.gov.al/ep-content/uploads/2021/06/Lista-e-perditesuar-e-perkthyesve-zyrtare-per-vitin-2021.pdf>

Hungareze	2	0
Kineze	2	4
Çeke	1	0
Norvegjeze /Suedeze / Daneze	1	1
Perse	0	4
Rome	0	1
Vllahë	0	1
Sllovene	0	1
Koreane	1	0
Japoneze	0	1
Total për kategori	236	715
Total Përkthyes	951	

Tabela 4.1

Ky numër i madh përkthyesish janë jo vetëm të diplomuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, por janë edhe të diplomuar në universitete jashtë vendit, gjithësesi vendin më të rëndësishëm e zënë ish studentë të FGJH-së.

Ky është një treguas se kemi potencialitet për prodhim të ketsteve rreklamuese për turizmin shqiptar duke kujtuar që deri më sot sasia e librave turistikë shqiptarë është nën nivelin prej 5 përqind dhe pjes tjetër mbulohet nga autore dhe shtëpi botuese të huaja. Mirëpo arritja e mbulimit të tregut në një të tretën me materiale promovuese të ardhur nga burime shqiptare është domosdoshmëri sepse tregu lëviz shumë shpejt dhe informacionet duhen freskuar gati në cdo sezon. Pa përmendur këtu që na mungojnë komplet gudia, doracakë të mzeve apo me ndonjë përjashtim audiogudat. Vetë muzetë do të vijnë shumë shpejt në derë të fakultetit për këtë fushë. Mjafton të kontrolloni flatëpalosjen e Butrintit në gjuhën gjermane për të kujtuar se në çfarë nivel është.



5. Tregu i punës në sektorin e turizmit

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka në fokus, theksohet se turizmi ka një kontribut gjithnjë e në rritje në eksportet globale dhe ka dëshmuar se është një burim i rëndësishëm i gjenerimit të të ardhurave dhe krijimit të vendeve të punës në shumë ekonomi. Për shkak se turizmi lidhet me një numër industrish dhe shërbimesh, ai përfshin dimensione sociale, kulturore dhe mjedisore përtej zhvillimit fizik dhe marketingut. Turizmi posedon potencial të rëndësishëm për të ndikuar në rritjen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe konkurrueshmërinë e tregut. Në veçanti, Shqipëria është e pozicionuar strategjikisht me orientim nga natyra dhe kultura, për t'i përmbushur pritjet gjithnjë e më shumë në rritje, për një treg të qëndrueshëm turizmi.

Gjatë vitit 2018 industria e turizmit dhe udhëtimeve ka gjeneruar në mënyrë direkte 91,548 vende pune, duke zënë kështu 8.04% në punësimin total. Siç paraqiten edhe në tabelën e mëposhtme, ky tregues është në rritje vit pas viti. Bazuar në kërkimet e bëra nga eTTC për Shqipërinë, parashikohet që turizmi të ketë rritje të vazhdueshme në tregun e punës:

Tabela 5.1: Kontributi direkt i turizmit në punësim dhe parashikimi në të ardhmen
(Burimi: World Travel and Tourism Council⁵)

Sipas viteve	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Kontributi direkt në punësim	91,548	92,515	93,450	94,920	96,351	96,792	96,887	97,211	98,358
Përqindja e zënë në punësimin në total	8,04%	7,99%	7,98%	8,05%	8,14%	8,16%	8,18%	8,28%	8,45%

Në mënyrë indirekte, gjatë vitit 2018, industria e turizmit dhe udhëtimeve ka gjeneruar në total 286,667 vende pune, duke përbërë kështu 25.17% të punësimin total. Siç paraqiten edhe në tabelën e mëposhtme, edhe ky tregues është në rritje të vazhdueshme. Bazuar në kërkimet e bëra nga eTTC për Shqipërinë, parashikohet që turizmi të ketë efekt në rritje të punësimin total në tregun e punës:

⁵<http://knoema.com/eTTC2019/world-travel-and-tourism-council-data>

Tabela 5.2: Kontributi total i turizmit në punësim dhe parashikimi në të ardhmen
(world Travel and Tourism Council⁶)

Sipas viteve	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Kontributi total në punësim	286,667	289,811	292,992	297,442	301,663	303,056	303,343	304,068	307,056
Përqindja e zënë në punësimin total	25.17%	25.03%	25.02%	25.23%	25.48%	25.56%	25.63%	25.9%	26.4%

Gjithashtu, për të matur nevojën e tregut të punës për ndërmjetës gjuhësorë, iu referuam edhe statistikave zyrtare të Instat⁷ për të parë disa tregues kryesorë në fushën e turizmit. Në faqen 8 të këtij dokumenti, në seksionin “Të huaj që kanë hyrë në vend... Në periudhën 2014-2018, hyrjet e shtetasve të huaj që vijnë në Shqipëri kanë qenë afërsisht 23.6 milionë persona. Vetëm gjatë vitit 2018, hyrjet e shtetasve të huaj janë 15,8% më shumë se viti 2017”⁸ më tej “Gjatë vitit 2018, hyrjet e shtetasve nga rajoni i Evropës zënë pjesën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj me 89,5%, duke u rritur me 13,2%”. Pyetjes se sa i rëndësishëm është turizmi në ekonomi, i është dhënë kjo përgjigje “Në periudhën 2013-2017, shpenzimet e turistëve të huaj (jo-rezidentë) në vendin tonë ndaj PBB janë mesatarisht 13,3%, ndërsa shpenzimet e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit tonë ndaj PBB janë mesatarish 11,2%. Në vitin 2017, shpenzimet e turistëve të huaj (jo-rezidentë) në vendin tonë ndaj PBB janë 14,9%, ndërsa shpenzimet e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtëvendit tonë ndaj PBB janë 11%.”

Këto fakte tregojnë se ky treg është një treg në rritje dhe se premtun një zhvillim të qëndrueshëm edhe nga pikëpamja e specialistëve të kërkuar, të cilët plotësojnë zinxhirin e specialistëve që lëvrojnë në këtë fushë.



⁶<http://knoema.com/WTTTC2019/ëorld-travel-and-tourism-council-data>

⁷<http://ëëë.instat.gov.al/media/5529/turizmi-ne-shifra.pdf>

⁸Ibid

5.1. Pyetësor dhe konkluzione me agjencitë dhe operatorët turistikë vendas

Krahas shifrave që pohojnë dobinë e turizmit në ekonominë kombëtare, si edhe rritjen e turistëve të huaj në Shqipëri, të cilët domosdoshmërisht kanë nevojë për komunikim nëpërmjet gjuhës së huaj, iu referuam për opinione agjencive dhe operatorëve turistikë vendas, për t'u thelluar më tej në këtë studim.

Për këtë qëllim përpilua një pyetësor dhe kontaktova drejtpërdrejt operatorët turistikë, për të marrë përgjigje prej tyre, të cilat paraqiten në detaje si më poshtë.

Pyetje 1: A keni patur ndonjëherë punonjës të diplomuar nga FGJH?

Nga rezultatet e anketimit figuron që 75% e agjencive turistike kanë patur eksperiencë me punonjës të cilët janë diplomuar në FGJH, ndërsa 25% e tyre nuk kishin patur ndonjëherë punonjës me formim nga gjuhët e huaja.

Në diagramën 5.1/1 paraqiten përgjigjet për pyetjen e parë:




Figura 5.1/1

Bazuar në anketimin e drejtuar ndaj agjencive turistike, për agjencitë që u përgjigjen pozitivisht pyetjes së parë, mësuam se pozicionet e punës të këtyre punonjësve kanë qënë përgjithësisht guidë turistike (56% e të punësuarve), operator në agjenci turistike (28% e të punësuarve) dhe një pjesë e tyre janë bërë sipërmarrës të vetë agjencive turistike (17% e të anketuarve).

Pyetje 2: A jeni të kënaqur me performancën e punonjësit?

Kjo pyetje iu drejtua atyre agjencive që kishin patur më parë ose kishin aktualisht punonjës me formim nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Nga përgjigjet e tyre figuroi se 89% e agjencive kanë qënë të kënaqur me performancën e punonjësve të tyre të diplomuar në FGJH. Ndërsa 11% e tyre nuk kishin patur një eksperiencë të mirë me punonjësit e tyre të diplomuar në FGJH.

Një pasqyrim më i qartë jepet sipas diagramës 5.1/2 më poshtë:




Figura 5.1/2

Pyetje 3: Çfarë aftësish të tjera do të dëshironit të kishin ata?

Në këtë pyetje drejtuesit e agjencive turistike ishin më të larmishëm me përgjigjet e tyre, por ne i përmbledhëm në tri kategori kryesore: Aftësi të njohjes së më shumë gjuhëve të huaja; Aftësi Komunikuese; Aftësi kompjuterike.

Konkretisht 11% e agjencive u përgjigjën se do të dëshironin që punonjësi i tyre të kishte aftësi dhe njohuri për të komunikuar në më shumë se një gjuhë të huaj, ndërsa 22% e agjencive punëdhënëse u shprehën se kërkonin që punonjësit e tyre të kishin aftësi të mira komunikuese, jo thjesht njohja e gjuhës së huaj, por edhe përqsja e punonjësit kundrejt klientelës turistike. Masa më të madhe, 67% e agjencive të anketuara, shprehën nevojën që punonjësit e diplomuar nga FGJH duhet të kenë aftësi kompjuterike për përdorimin e programeve bazë si Office, Email, etj. Per te rritur efikasitetin e punonjësve të tyre, agjencitë kanë përdorur trajnimin e vazhduar për punonjësit e tyre.

Diagrama më poshtë jep më të qartë grupimin e përgjigjeve për këtë pyetje:




Figura 5.1/3

Konstatuam se nevoja në treg për specialistë komunikimi ndërgjuhësore me njohuri tematike në fushë të studimit është evidente dhe se shkolla luan një rol thelbësor në përgatitjen e tyre. Kjo konkretizohet edhe më poshtë në opinion e vlerësimit të një kompanie private: **Aneks 1:** Dokumenti lëshuar nga një prej agjencive në treg.

Ministria e Turizmit publikon çdo vit Listën e Udhërrëfyesve Turistikë të Çertifikuar me Kategorinë "Kombëtar"⁹, ku vendin kryesor në masën 75% e zënë studentë të diplomuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Të dhënat janë të publikuara sipas URL më poshtë cituar.

5.2. Ofruesit e arsimimit mbi turizmin

Programet e gjuhëve moderne përgatisin të diplomuar me dije të qëndrueshme, aftësi dhe kompetenca profesionale në më shumë se një gjuhë. Aktualisht, formimet shihen si ndërdisiplinore çka nënkupton shkriren e shumë disiplinave në një program formimi me qëllim fleksibilitetin e punësimit.

Në këtë prizëm, të diplomuarit zotërojnë jo vetëm aftësitë gjuhësore, por edhe aftësi të komunikimit ndërkulturor, aftësi krijuese nëpërmjet gjuhës së huaj, të të menduarit kritik, të

⁹<http://turizmi.gov.al/ep-content/uploads/2020/04/Lista-e-udh%C3%ABrr%C3%ABfyesve-kategoria-KOMBETAR.pdf>

analizës dhe të komunikimit të cilat iu shërbejnë si për të vazhduar studimet e mëtejshme në ciklin e dytë, ashtu edhe për të punuar në sfera të ndryshme të veprimtarisë publike dhe private ku nevojitet komunikimi në gjuhë të huaj.

Kjo vlerë e tyre shtohet më shumë kur studentët përqendrohen jo vetëm në përvetësimin e gjuhëve të huaja por edhe në disiplina të tjera, duke ju dhënë atyre mundësi të punësohen në agjenci turistike, institucione publike, përkthim-interpretim për qëllime promovimi të trashëgimisë materiale e jomateriale apo edhe biznes. Në kohët e sotme me një ekonomi të globalizuar bëhen gjithnjë e më të qarta shkëmbimet ndërkulturore.


Rritja e industrisë së turizmit në gjithë botën dhe në Shqipëri kërkon të diplomuar që dinë disa gjuhë e që kuptojnë nevojat kulturore të turistëve të ndryshëm. Fakt është që, sipas statistikave të Instat-it, numri i turistëve të huaj që vizitojnë Shqipërinë ka ardhur gjithnjë në rritje. Po në rritje paralele, shkon edhe nevoja që ka shoqëria për ndërmjetës gjuhësorë me njohuri tematike edhe në fushën e turizmit.

Nga ana tjetër, nisur nga praktika evropiane dhe jo vetëm, në programe me karakter gjuhësor të tri cikleve të studimit, vihet re se programet e Gjuhëve moderne me fokus në turizëm iu ofrojnë studentëve mundësi të fitojnë aftësi për të punuar me njerëz nga kultura të tjera në fushën e turizmit duke i pajisur ata me aftësi gjuhësore, jashtë gjuhësore apo tematike, në kuptim të thellë të kulturës dhe një perspektivë ndërkulturore.

Përsa i përket përgatitjes së punonjësve për sektorin e turizmit, vlen të theksohet, se ofruesit e arsimimit mbi turizmin dhe trajnimeve profesionale janë kryesisht shkollat e mesme profesionale dhe universitetet. Disa universitete publike kanë në program lëndë mbi turizmin, por vihet re nevoja për programe të mirëfillta me kurrikul të plotë të turizmit.

Produktet e formimeve ndërgjuhësore dhe ndërdisiplinore ku gjuha e huaj vihet në funksion të ushtrimit të një profesioni që ka në bazë komunikimin janë tanimë pjesë organike e tregut të standardizuar që operon në fushën e turizmit. Nisur nga kjo praktikë e vendeve evropiane, me anë të një studimi tregu të kryer nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, u synua verifikimi i hipotezës për ekzistencën e programeve të tilla edhe në vendin tonë e madje edhe në rajonin e Ballkanit.

Aktualisht, Gjuha e huaj për Turizëm nuk ofrohet në asnjë program studimi në nivel bachelor master apo doktoratë, në vendin tonë. Nevojat në rritje të turizmit kërkojnë që të përgatiten punonjës më aftësi gjuhësore, tematike edhe të komunikimit.



6. Pyetësor dhe konkluzione me studentët e diplomuar në FGJH

Veçanërisht, ky punim përfshin gjurmimin e punësimit të studentëve që kanë përfunduar studimet në programet e ofruara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në katër vitet e fundit akademike, për të gjitha degët. Ai synon të analizojë të dhënat e ofertës dhe kërkesës për punësimin e të rinjve që diplomohen në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

6.1. Organizimi dhe metodologjia

Në kushtet e mungesës së statistikave zyrtare për punësimin e studentëve sipas Universiteteve/Fakulteteve, u organizua pyetësori me studentët që kanë mbaruar studimet në vitet 2018-2021. Synimi ishte evidentimi i problematikës me të cilën përballen studentët në procesin e gjetjes së punës, sektorët ku ata punësohen, roli i programeve të studimit në suksesin e gjetjes së punës, roli i praktikës mësimore e profesionale, etj.

Pyetësori, i realizuar online, ka specifikat e mëposhtme:

1. Rezultatet e këtij pyetësori gjenden në Office 365, në URL:
https://forms.office.com/Pages/DesignPage.aspx?lang=en-US&origin=OfficeDotCom&route=Start#Analysis=true&FormId=NhkHq6jtTEibPfvSHb0IJhrRcuEë-0xBqR_o11jtxlFUN11SQVVUSFVYMVBUOTVTUIJSSUFJMTFOVC4u
2. Transmetimi i të dhënave është bërë me certifikatë sigurie nga vetë Office365, në mënyrë që askush mos të arrijë të lexojë çfarë vizitori (studenti) ka dërguar tek serveri ku mbliidhen të dhënat.
3. Faqja është e mbrojtur nga sulmet kibernetike nëpërmjet rrjetit të serverave që ofron cloud.com.

Pyetësori, si një instrument metodologjik për gjurmimin e statusit të të diplomuarve u shpërnda nga adresat zyrtare të fakulteteve, duke përdorur databazën e të dhënave të sekretarive mësimore gjatë regjistrimeve të studentëve dhe të zyrës së orientimit të karrierës. Pyetësori u plotësua nga 202 studentë, por është e vështirë të përcaktohet një shkallë e saktë e përgjigjeve të marra, sepse adresat e e-maile-ve nuk janë gjithmonë të aksesueshme.

Ky test i parë na dha një mësim të mirë që kontaktet e Fakultetit me të diplomuarit ka nevojë të mbahen edhe pas diplomimit të tyre, duke përcjellë informacione të dobishme për të dy palët: studentët e punësuar mund t'i ofrojnë fakulteteve të tyre informacione të dobishme nga institucionet ku janë punësuar, ndërsa fakultetet mund të shtrijnë publicitetin e tyre në një publik më të madh. Kjo lidhet edhe me faktin që website i fakultetit ende nuk është mjaftueshëm

atraktiv, saqë t'i mbaj studentët të interesuar për informacionet dhe të rejat që ofronedhe pas diplomimit, prandaj ëeb i FGJH duhet zhvilluar edhe në këtë drejtim.

Pyetëtori synon të identifikojë dhe të kontaktojë studentët e diplomuar së fundmi, të studiojë shpërndarjen gjeografike, pritshmëritë dhe përqëndrimin e tyre, tendencat dhe profilin e situatës së punësimit dhe aftësimin e tyre në tregun e punës. Mënyra e kampionimit është Simple Random Sample (SRS) dhe rezultatet nuk synohen të jepen të disagreguara me rajone. Që në kampionim mbahet parasysh vështirësia për kontaktimin dhe mbajtjen e lidhjeve me Fakultetin. Periudha e anketimit u përcaktua dy javë. Studentët u kontaktuan nëpërmjet kontakteve që ekzistonin dhe pyetëtori u shpërnda online.

Pyetëtori u hartua në tre seksione. Në pjesën e parë merret informacion mbi moshën, vendlindjen, vendbanimin, diplomimin, fakultetin dhe programin. Në pjesën në vazhdim mblidhet informacion mbi statusin e punësimit, historikun e punësimit, barrierat e tregut të punës, përputhshmëria dhe vlefshmëria e formimit të njohurive të marra në fakultet në gjetjen e një pune dhe më tej në performancën në punë, promotorët në tregun e punës dhe aftësimi i mëtejshëm. Kurse në pjesën e fundit, të diplomuarveu kërkohet të japin opinionin e tyre mbi ndryshimet që mund të bëhen në kuadrin e periudhës tranzitore nga student në tregun e punës.

Të dhënat e mblledhura janë subjekt i ruajtjes së konfidencialitetit dhe të dhënat identifikuese nuk do të publikohen. Ky pyetësor synon gjithashtu të ngrrejë një strukturë dhe ta vazhdojë më tej punën e bashkëpunimit për promovimin e studentëve në tregun e punës nëpërmjet praktikave mësimore, qëndrës së karrierës apo kontakteve dhe kërkesave të ardhura, por gjithashtu të studiojë më tej edhe për studentët që nuk promovohen nga Fakulteti për përshtatjen e tyre në tregun e punës. Pyetjet janë cilësore, sasiore, të hapura apo me kategori të shkallës së Likertit me një shkallë vlerësimi 1-10.

6.2. Pyetëtori ndaj studentëve të diplomuar në FGJH

Pyetje 1: Kur jeni diplomuar në FGJH?

Thirrjes për këtë pyetësor i janë përgjigjur studentë nga katër vitet e fundit të diplomimit, ku dominojnë ata të vitit 2020:

Viti i diplomimit	2018	2019	2020	2021
Shakalla e përgjigjes	25%	20%	37%	19%






Figura 6.2/1

Pyetje 2: Vendlindja sipas qarkut

Përqindjen më të lartë të të intervistuarve e përbëjnë studentët me origjinë nga Tirana 25% dhe të lindur jashtë vendit 23%. Qarqet e tjera kanë një përqindje më të ulët të të intervistuarve, por që përbëjnë larmishmëri nga të gjitha qarqet e Shqipërisë. Vihet re, se një numër i konsiderueshëm studentësh që fillojnë studimet në FGJH kanë lindur jashtë vendit. Ky tregues na ndihmon të kuptojmë, se studentet e shohin si avantazh vijimin e studimeve në gjuhën që njohin nga lindja dhe një mundësi për të ecur më lehtë në krijimin e një profesioni.




Figura 6.3/2

Diagrama më sipër jep një pasqyrë më të qartë të shpërndarjes së studentëve nga qarku i origjinës.



Pyetje 3: Vendbanimi sipas qarkut:

Nga të dhënat e studentëve të intervistuar, bazuar në ata që kanë përfunduar studimet 4 vitet e fundit, duke marrë në konsideratë vendin e tyre të banimit aktualisht, vëmë re se rreth 71% e studentëve që kanë përfunduar studimet në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, qëndrojnë në Tiranë. Kjo për faktin e mundësive që krijon Tirana për punësim. Rreth 8% e studentëve aktualisht janë larguar jashtë vendit, që mund të konsiderohet edhe kthim në vendin e origjinës, ndërsa një pjesë e tyre (21%) kthehet dhe banon në qarkun e origjinës brenda Shqipërisë.

Këtë e dëshmon edhe diagrama më poshtë:




Figura 6.3/3

Nga figura më sipër, shohim qartë që vendi ku studiojnë i ka ofruar të diplomuarve përshtatje me tregun e punës dhe mundësi për t'u integruar dhe për të ndërtuar një të ardhme në Tiranë.

Pyetje 4: Në vitin e parë pas diplomimit në FGJH, keni qëndruar në Tiranë, apo jeni kthyer në vendin (qarkun) e origjinës?

Në vijim të statistikave të mësipërme (pyetje 3), konfirmohet edhe nga vetëpërgjigjet e të anketuarve, se 71% e tyre vijojnë të qëndrojnë në Tiranë pas vitin të parë të studimeve, 20% e studentëve të diplomuar përpiqen të zhvillojnë profesionin në vendin e tyre të origjinës (brenda apo jashtë Shqipërisë), ndërsa 9% e të diplomuarve vlerësojnë mundësinë për t'u përshtatur në qarqe më të mëdha se vendi i origjinës apo edhe jashtë Shqipërisë.




Figura 6.3/4

Pyetje 5: Programi i studimit Bachelor që keni ndjekur në FGJH?

Numrin më të madh të të intervistuarve e zënë studentët që kanë zhvilluar studimet bachelor në gjuhë Angleze (38%). Kjo e dhënë del në përputhje edhe me numrin e studentëve të regjistruar vit pas viti, ku veçanërisht në vitet e fundit, orientimi i studentëve është drejt programeve të ofruara në gjuhën angleze. Studentet e gjuhës Frënge dhe Italiane përbëjnë 19% të të intervistuarve në secilën degë, më pas zënë vend studentët e diplomuar në gjuhën Gjermane (14%), të cilët pasohen në masë më të vogël nga studentët e gjuhës Spanjolle (3%) dhe Greke (3%), studentët e gjuhës Turke (2%) dhe Ruse (1%) si pjesëmarrës në këtë pyetësor.





Figura 6.3/5



Të dhënat e mësipërme tregojnë që kemi një përfshirje nga të diplomuar në të gjitha degët dhe pjesëmarrja e studentëve është në përputhje të drejtë edhe me numrin e të regjistruarve, ku çdo vit vendin kryesor e zënë 4 gjuhët e para dhe gjuhët më të rralla kanë numër të vogël të të regjistruarve, që rrjedhimisht diplomojnë një numër më të vogël studentësh krahasuar me degët e tjera.




Figura 6.3/5.1

Figura 2.3/5.1 na ndihmon të kuptojmë se 90% e studentëve vijojnë studimet në programet master që ofron FGJH dhe vetëm 10% e tyre nuk vendosin të thellohen në studime të mëtejshme master. Lidhur me detajimin në programet master, 62% të anketuarit kanë zhvilluar studimet në programin “Master Shkencor në Mësuesi për arsimin e lartë të mesëm” në gjuhët respektive, të cilët zënë masën më të madhe të të anketuarve, më pas vjen programi “Master Shkencor në Përkthim - Teknik Letrar dhe Interpretim” me 15% të të anketuarve, i pasuar me 4% të anketuarve të diplomuar në programin “Master Shkencor në Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik”.

Pyetje 6: A keni punuar gjatë kohës së studimit në FGJH?




Figura 6.3/6



Përgjigjet në këtë pyetje na ndihmojnë për të kuptuar që studentët e FGJH-së integrohen shpejt në tregun e punës. Bazuar edhe nga diagrama me sipër shohim se 67% e të intervistuarve kanë qënë në marrëdhënie pune gjatë periudhës së studimeve në FGJH.

Pyetje 7: A keni qënë ndonjëherë në marrëdhënie pune?

Kësaj pyetje i është përgjigjur pozitivisht 92% e të anketuarve të diplomuar në FGJH, negativisht janë përgjigjur 7% e tyre, ndërsa 1% ka dhënë përgjigje të papërcaktuar.

Diagrama më poshtë na jep një pasqyrim të qartë:




Figura 6.3/7

Pyetje 8: Keni patur vështirësi në gjetjen e një pune në profilin tuaj?



Figura 6.3/8



Përgjigja më e shpeshtë 61% e të anketuarve, tregon se studentët e diplomuar kanë hasur vështirësi në gjetjen e punës në profesionin e tyre, ndonëse bazuar në përgjigjet e pyetjes 6 (shih. Fig.2.3/6) 67% e tyre kanë patur eksperiencë pune në periudhën e studimeve. Gjithashtu vërehet se 30% e të anketuarve nuk kanë hasur vështirësi në gjetjen e punës në profesionin e tyre, ndërsa për 9% të të anketuarve që kanë kthyer një përgjigje evazive “tjetër”, figuron se pjesa më e madhe e tyre nuk kanë kërkuar të gjejnë punë në profesionin përtë cilin kanë përfunduar studimet, ose kanë pranuar ofertën më të shumtë të punës në call center.

Studentët të cilët janë përgjigjur në pyetjen më sipër, që nuk kanë patur vështirësi në gjetjen e punës në profesion, ia dedikojnë këtë sukses angazhimit të tyre korrekt në mësimdhënie dhe referencave të marra nga pedagogët e tyre, të cilët janë treguar suportive dhe u kanë sygjyer në vende pune vakante. Gjithashtu ndihmesë kanë qënë kontaktet e krijuara gjatë praktikës profesionale, apo edhe nga eksperiencia pune gjatë kohës së studimeve.

Pyetje 9: Nëse keni hasur vështirësi në gjetjen e një pune në profilin tuaj, cilat kanë qënë ato?

Fokusi i përgjigjeve në këtë pyetje është vendosur tek studentët (61% e të anketuarve) të cilët kanë hasur vështirësi në gjetjen e punës në profesionin e tyre. Duke qënë se kjo fushë ishte narrative edhe përgjigjet e të anketuarve janë të lira dhe jo të standardizuara, por për të lehtësuar analizën ato u kategorizuan në 7 grupe kryesore. Përgjigjet për vështirësitë në gjetjen e një pune në profilin e tyre, janë paraqitur sipas tabelës më poshtë dhe diagramës së paraqitur në figurën 6.3/9.

Kategoritë e përgjigjeve	Rezultatet e përgjigjeve në %
Mungesë eksperience në profesion	51%
Mungon oferta për profesionin	25%
Mungesë informacioni për vende vakante	3%
Nuk njihet diploma jashtë vendit	2%
Pagesë e ulët e profesionit	3%
Tjetër	16%



Bazuar në përgjigjet e të diplomuarve, 51% e tyre shprehen se diplomohen pa patur eksperiencë në fushën e profesionit të tyre dhe shkolla nuk ia jep këtë mundësi as me praktikën profesionale. Për më tepër, për ata që diplomohen si mësues, duhet të pajisen edhe me një licensë profesionale, përveç diplomës master i shkencave. Aplikimi për t'u pajisur me këtë licensë, kërkon si kriter eksperiencën në punën e mësuesit dhe ky rreth vicioz i mban ata pa zgjidhje.

Për 25% të të diplomuarve, të cilët kanë hasur vështirësi për punësimin e tyre në profesion, vlerësojnë si pengesë kryesore mungesën e ofertës së punës për profesionin e tyre, edhe në rastet kur ata kthehen në qytetin e origjinës. Ata shprehen se oferta e punës është thujtë inekzistente, për studentët e diplomuar me profesione në gjuhët e rralla.

Studentët që kanë hasur vështirësi në integrimin në punë në tregun e huaj 2%, shprehen se vështirësia vjen nga diplomat e tyre, të cilat nuk njihen dhe as kategorizohen si profesion dhe se kërkohen kurse të mëtejshme për rritjen e nivelit të gjuhës së huaj.

Studentët të cilët kanë konsideruar mungesën e informacionit për vende vakante, si vështirësinë primare për gjetjen e punës së tyre në profesion, përbëjnë 3% të të anketuarve, ndërsa 3% tjetër konsideron shpërblimin e ulët që ka profesioni i tyre dhe nuk e shohin profesionin si punë kryesore. Ndërsa në kategorinë "Tjetër", që zë rreth 16% të të anketuarve, janë studentë që në tregun e punës kanë hasur vështirësi, që nuk lidhen me diplomën e tyre, por me nepotizmin gjatë përzgjedhjes, mungesën e meritokracisë, etj.

Pyetje 10: A jeni i/e punësuar aktualisht?



Figura 6.3/10



Rezulton se 79% e të anketuarve i janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetje, ndërsa 21% e tyre i janë përgjigjur negativisht. Kjo është një përgjigje optimiste, duke parë se pavarësisht vështirësive në gjetjen e punës në profesion, studentët e FGJH-së gjejnë përshtatje dhe mundësi punësimi në tregun e punës.

Pyetje 11: Në cilin sektor jeni punësuar?

Përgjigjet e të anketuarve tregojnë, se pjesa më e madhe e të punësuarve kanë gjetur hapësirë në sektorin privat 68%, ose janë të angazhuar në tregun e punës si profesionistë të lirë. Gjithashtu, edhe në sektorin publik janë punësuar në masë të konsiderueshme 14% e të anketuarve.




Figura 6.3/11

Diagrama më sipër jep një pamje të qartë tësektorëve të punësimit të studentëve të diplomuar nga FGJH. Pra sektori privat zë pjesën më të madhe të ofrimit të punës, ku mund të përfshimë edhe kategorinë “Profesionistë të lirë”, të cilët janë gjithashtu pjesë integrale e sektorit privat.

Pyetje 12: Me çfarë angazhimi jeni punësuar?




Figura 6.3/12



Figura më sipër tregon, që më së shumti të diplomuarit arrijnë të pozicionohen nëpunë, si punëmarrës me kohë të plotë dhe 32% e tyre janë punëmarrës me kohë të pjesshme, si pasojë edhe e llojit të punës.

Pyetje 13: Çfarë profesioni ushtroni aktualisht:

Kategoriprofesionesh	Përgjigjet ne %
Mësimdhënie	29
Agjent turistik	4
Call Center	24
Diplomaci	1
Përkthyes	7
Shërbim klienti në sektorë të ndryshëm biznesi	11
Sipërmarres në fusha të ndryshme biznesi	8
Sekretari	4
Stjuart	2
Nëpunës në sektorët e gjuhës së huaj	4
Tjetër	






Figura 6.3/13


Studentët e diplomuar kanë gjetur përshtatje në tregun e punës në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, megjithëse jo gjithmonë në profesionin e tyre.

Pyetje 14: Në cilin prej këtyre sektoreve të turizmit keni eksperiencë pune (edhe informale)?

Sektorët e turizmit	Përgjigjet ne %
Agjencitë turistike	20%
Spektori shtetëror që mbulon turizmin	3%
Agjenci të ndryshme shërbimesh publike	21%
Qendrat kulturore në komuna	4%
Kompanitë medias	6%
Televizione lokale	1%
Organizatrat ndërkombëtare	7%
Shoqata	14%



Qendra të trashëgimisë kulturore	1%
Ndërmarrje të prodhimeve turistike	5%
Biznese kombëtare dhe ndërkombëtare	19%



Kësaj pyetje i janë përgjigjur të gjithë të anketuarit dhe tregojnë se ata kanë patur mundësi të jenë pjesë e tregut të punës të paktën në një sektor të turizmit.

Pyetje 15: Sa mendoni se ju ka ndikuar formimi juaj në FGJH në performancën në punë?

Kjo pyetje kishte si përgjigje një shkallë vlerësimi nga 1-10, në varësi të ndikimit që ka patur formimi i studenteve në fakultet në performancën e tyre në punë. Duke nxjerrë një mesatare aritmetike mbi vlerësimin e përgjithshëm të të gjithë të anketuarve është marrë vlera 7.09 (një ndikim i moderuar, mbi mesatar).

Për të analizuar edhe më në detaje, shohim se 50% e të anketuarve kanë dhënë një vlerësim mbi 8, duke e konsideruar me ndikim të lartë për performancën në punë, formimin, e tyre në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Kjo i jep zë vlerës që programet e FGJH ndërtohen dhe përditësohen në funksion të tregut të punës, si edhe oftohen me cilësi të lartë nga personeli akademik. Ndërkohë 11% e të anketuarve kanë dhënë një vlerësim të ulët 1-3 për këtë ndikim.




Figura 6.3/15

Pyetje 16: A ju ka ndihmuar diploma në FGJH për të gjetur një punë?

Edhe kjo pyetje kishte si përgjigje një shkallë vlerësimi nga 1-10, në varësi të ndikimit që ka patur diploma FGJH për gjetjen e një pune. Ndryshe nga rezultati i vlerësimit mësipër, nga të anketuarit del se diploma ka patur një ndikim relativisht të ulët në gjetjen e një pune. Mesatarja aritmetike mbi vlerësimin e përgjithshëm të të gjithë të anketuarve është 6.34.




Figura 6.3/16

Nga diagrama më sipër vihet re, se edhe ata që kanë dhënë vlerësim shumë të lartë për ndikimin që ka patur formimi i marrë nga studimet në FGJH, kanë patur vështirësi në gjetjen e punës në përputhje me diplomën e tyre.

Pyetje 17: A e keni kryer praktikën mesimore të organizuar nga FGJH?



Figura 6.3/17

Kjo diagramë nga jep një imazh të qartë, se në katër vitet e fundit realizimi i praktikës mësimore ka qënë në nivelin reth 50%. Shkak i rëndësishëm është Pandemia Botërore Covid-19, e cila ka efektuar në masë të lartë realizimin e praktikës mësimore. Por duhet theksuar se përgjigje negative kanë dhënë edhe studentët e diplomuar në vitin 2018 dhe 2019 të cilët kanë qënë jashtë këtij shkaku madhor.

**Studentë që nuk kanë kryer praktikën mësimore,
sipas viteve të diplomimit**




Figura 6.3/17.1



Pyetje 18: A jeni trajnuar në lidhje me pozicionin e punës?

Trajnime në punë




Figura 6.3/18

Në bazë të përgjigjeve të të anketuarve, pjesa më e madhe e tyre kanë marrë trajnime shtesë në punë, për të marrë njohuri specifike për pozicionin e punës që kryejnë.

Pyetje 19: A do të dëshiroje të merrje aftësi të tjera, që nuk ishin pjesë e studimeve të tua?

Interesi për aftësi të tjera gjatë studimit




Figura 6.3/19

Përgjigjet e të diplomuarve janë natyrshëm në këtë nivel (shih figurën sipër), duke qënë se ata kërkojnë të kenë mundësi për të fituar sa më shumë aftësi gjatë kohës së studimeve, në mënyrë që të jenë më të përgatitur për tregun e punës. Prandaj 66% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht pyetjes.

Për të interesuarit u kërkuan detaje lidhur edhe me llojin e aftësive plotësuese të kërkuara, përgjigje të cilat paraqiten në tabelën dhe diagramen më poshtë:

Aftësitë e kërkuara sipas kategorive	Rezultatet në %
Aftësi kompjuterike	7%
Aftësi komunikuese	9%
Aftësi menaxheriale	12%
Biznes	7%
Gjuhë shtesë	5%
Marrëdhënie me Publikun	8%
Pedagogji	3%
Praktikë profesionale	28%
Psikologji	3%
Sportive	3%
Turizëm	6%
Tjetër	10%






Figura 6.3/19.1

Pjesa më e madhe 55% e të anketuarve, kërkojnë të fitojnë aftësi të tjera, që nuk lidhen drejtpërdrejtë me programin e tyre të studimit, si psh.: aftësi kompjuterike, komunikuese, menaxheriale, biznesi, marrëdhënie me publikun, sportive, si edhe të tjera. Paraqitja e kërkesave të intervistuarve tregon interesin e tyre për të patur formim shumë-profilesh që në diplomën e tyre. Ndërkohë 28% e të intervistuarve ndjejnë nevojë për rritjen e aftësive të tyre profesionale, me zhvillimin më tej të praktikës profesionale, ndërsa 17% e tyre dëshirojnë të kenë njohuri më të thelluara në lëndë që zhvillojnë gjatë studimeve si psh.: pedagogji, psikologji, turizëm dhe gjuhë të huaja shtesë.

Pyetje 20: A do të dëshiroje trajnime me module praktike në FGJH?




Figura 6.3/20



Diagrama më sipër pasqyron qartë interesin e lartë të të diplomuarve, për të marrë pjesë në trajnime praktike në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, duke qënë se 61% e tyre i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes. Gjithashtu, të interesuarit kanë dhënë komente edhe mbi llojet e moduleve të mundshme të trajnimeve, që janë me interes për rritjen e tyre profesionale.

Moduletë kërkuara për trajnim	Rezultatet në %
Komunikim	5%
Kompjuter	1%
Kulturë sportive	1%
Metoda të reja në mësimdhënie	35%
Module për Përkthim	16%
Praktikë	19%
Turizëm	4%
Tjetër	19%




Figura 2.3/20.1



Gjithashtu, një analizë e nevojës së tregut të punës në fushën e turizmit, u bë edhe duke kontaktuar me studentë të cilët aktualisht studiojnë në FGJH dhe që pjesë të veprimtarisë së tyre kanë edhe angazhimin në fushën e turizmit, përkatësisht studentë që shoqërojnë grupe të huajsh që vijnë në Shqipëri. Për të dhënë një paqyrim transparent të opinioneve të tyre, në Aneks 2 më poshtë, janë vendosur dy nga këto opinione të studenteve të përcjella me email.

7. Konkluzione mbi studimin e kryer

Në përfundim të këtij studimi tregu, me qëllim matjen e nevojës në treg për punësimin e specialistëve/ndërmjetësve ndërgjuhësorë me njohuri tematike në fushë të turizmit, pohojmë se nisur nga faktet që treguan peshën e turizmit në ekonomi, nevojën e dukshme dhe të matshme në këndvështrim të operatorëve në treg për specialistë/ndërmjetës komunikimi ndërgjuhësorë me njohuri tematike në fushë të turizmit, është evidente nevoja e studentëve aktualë për të përsosur dhe thelluar aftësitë e tyre ndërgjuhësore dhe ato profesionale *knoë-hoë* në fushën e turizmit dhe se shkolla luan një rol thelbësor në përgatitjen e tyre.


- FGJH ka mundësitë dhe marrëveshjet për bashkëpunime me universitete të huaja që ofrojnë programe të tilla studimi.
- Agjencitë turistike do përfitojnë duke punësuar profesionistë të pajisur me njohuri dhe aftësi të mira komunikimi në gjuhë të huaja.

Ky program studimi standardizon një profesion të njohur e të pranuar si të tillë në fakultetet homologe të Evropës perëndimore: atë të ndërmjetësit gjuhësor në fushën e turizmit.

- Kërkesa për këtë program është e madhe në kushtet e rritjes së industrisë së turizmit në vendin tonë dhe të shkëmbimeve turistike me jashtë.
- Mundësitë e shumta të punësimit për të diplomuarit.

Programi i studimit ndikon drejtpërdrejt në tregun e punës, në organizatat e llojeve të ndryshme në disa mënyra:

1. Plotëson zinxhirin e profesioneve dhe krijohet mundësi për punësim dhe vetëpunësim;
2. Ofrohen shërbime që më parë nuk janë ofruar;
3. Përmirësohet mënyra e ofrimit të produkteve turistike të vendit;
4. Përmirësohen performancat e agjencive turistike sepse ndërmjetësit turistike janë të përgatitur për komunikim ndërkulturor;
5. Ofrohen mundësi pune për intitucionet dhe agjencitë në marrëdhnje më të huajt;
6. Rritet cilësisht komunikimi turistik i një vendi i cili gjeneron më shumë të ardhura.



Bazuar në “Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023”¹⁰, të publikuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, turizmi në vendin tonë ka një potencial për të gjeneruar edhe më shumë vende pune në të ardhmen, por nga ana tjetër nevojitet domosdoshmërisht arsimimi dhe trajnimi i punonjësve të sektorit turistik në mënyrë që shërbimi që u jepet vizitorëve të jetë profesional.



¹⁰<https://turizmi.gov.al/ep-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>

Aneks 1:

Opinion i agjencisë Europa Travel and Tours



Opinion vlerësimi për nevoja të specialistëve të komunikimit përmes gjuhës së huaj në tregun e punës në fushën e turizmit.

Agjencia jonë Europa Travel & Tours operon në tregun shqiptar që prej vitit 1996. Duke qenë se veprimtaria e përditshme e punës sonë ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve në fushën e turizmit, të cilat kanë në fokus vendosjen e komunikimit me turistë të huaj, nevoja dhe prania e një stafi të formuar në drejtime gjuhësore të orientuar drejt komunikimit në gjuhë të huaja, ka qenë domosdoshmëri për ne.

Po kështu, rritja në dukje e turistëve që vizitojnë Shqipërinë në vendin tonë dhe ndërmjetësimi i agjencisë sonë për pritjen dhe akomodimin e tyre ka bërë që kërkesat tona për punësimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të stafit të fokusohen drejt studentëve të cilët kanë së paku njohuri në dy gjuhë të huaja por edhe në ato specifike të fushës së turizmit.

Për këto arsye, shprehemi se formime universitare që gërhojnë aftësinë dhe kompetencën në gjuhë të huaja së bashku me njohuritë tematike dhe profesionale të fushës së turizmit, duhet të jenë në qendër edhe të formimit të studentëve të cilat do të punësohen në të ardhmen në sektorin e komunikimit. Punonjës të kualifikuar në formime të tilla do të rrisin vizibilitetin edhe të aktivitetit tonë, do të shtojnë produktet turistike të ofruara nga ne si edhe do të standardizojnë profesionin e ndërmjetësit gjuhësor.

Silvana Dracini
Administratore

EUROPA Travel & Tours T: +355(4)2221583 / 2239807
Address: Street "Bardhok Biba", F: +355(4)2268822
Pallati Golden Trema, Kati 3, Tiranë/Albania E: info@europatravelalbania.com

Page 1



Aneks 2

Opinione të studenteve të përcjella me email:

Opinion 1

STUDENTE: Mirjana Nurja

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Viti i II Master i Shkencave në Mësuesi e gjuhës frënge, 2020.

Profilizimi im në FGJH është në mësuesi por meqenëse gjuha e huaj lidhet dhe me komunikim, kulturën, udhëtimet gjithnjë kam ruajtur interes për degën e turizmit ndaj vendosa që krahas profilizimit në fakultet të ndiqja dhe një trajnim për t'u licensuar si Udhërrëfyes Kombëtar në Shqipëri. Disangarekomandimet e mia përdegën e turizmitnë FGJH do tëishin:

- *Një informim më i gjerë tek studentët (përveç prezantimit të kurrikulës të secilit profil të gjuhës së huaj (mësuesi, përkthim dhe komunikim e turizëm) mendoj se do të ishte përparësi që studentët të ndiqnin një takim prezantues mbi degën e turizmit ku në fund të prezantimit të gjithë pjesëmarrësit të ndanin eksperiencat e tyre, kontaktet që mund të kenë për t'i ardhur në ndihmë të tjerëve.*
- *Organizimi i ekspeditave apo ekskursioneve me pedagogë të fakultetit dhe të jashtëm, në mënyrë që studentët të njohin më nga afër terrenin ku do iu duhet të punojnë. (Përveç praktikave që duhet të ndiqen në mbyllje të masterit)*
- *Bashkëpunime me Fakultetin e Arkeologjisë, Historisë dhe me Ministrinë e Turizmit.*
- *I vlefshëm do të ishte dhe aplikimi i një Masteri Profesional mbi Turizmin që do t'u mundësonte studentëve të punësoheshin dhe si guida pa qenë nevoja të ndjekin trajnime për Udhërrëfyes Kombëtar.*
- *Bashkëpunime me agjenci që ofrojnë shkëmbime kulturore jashtë vendit, ku studentët do të kishin mundësi dhe të punonin por edhe të njihnin më mirë kulturën e gjuhës të çelën studiojnë dhe si rrjedhojë do të ishin më të përgatitur për të pritur turistët në vendin e tyre.*



Opinion 2

STUDENTE: Ani Cullhaj

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Master i Shkencave në Përkthim-Interpretim, 2020.

Mendim mbi fushën e turizmit në kurrikulat universitare.

Bazuar në një eksperiencë modeste (3 vjeçare) në fushën e turizmit po listoj disa pika thelbësore që duhen ezauruar që në fillimet e orientimit në turizëm si profesion.

Studimet në fushën e turizmit i japin mundësi studentëve të punojnë në disa sektorë të ndryshëm të tij. Bazuar në eksperiencën time po i referohem kryesisht operimit si Udhërrëfyes Turistik (terren) por edhe në Agjent Turistik në zyrë.

Për momentin në Shqipëri nuk ka një shkollë të mirëfilltë të formimit të guidave. Vitet e fundit (2019) për herë të parë u bë një kualifikim më serioz i guidave duke ndjekur një trajnim/kurs me pagesë që mundësonte licensimin më pas nga Ministria e Turizmit. Dega e studimeve Komunikim – Turizëm me aq informacion sa kam marrë, nuk mundëson punësimin në tregun turistik. Ka njohje kreditesh të studimeve në këtë degë kur ndjek trajnimin e akredituar nga Ministria por nuk të ofron daljen si guidë. Për sa i përket agjencive nuk përbën ndryshim të madh pasi e bëjnë vetë trajnimin e punonjësve të tyre. (Kjo bazuar gjithmonë në eksperiencën time, informacionit që kam marrë nga studentë të fushës së turizmit dhe nga agjenci ku kam punuar.)

Duke qenë se kam studjuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, mendoj se do ishte më efikase dhe cilësore për turizmin në Shqipëri nëse guidat e ardhshme apo agjentët turistikë do të dilnin nga ky fakultet. E mbështes këtë mendim bazuar në këto pika të cilat i kam konsideruar pika të forta të mijat në fushës së turizmit dhe i kam zhvilluar në FGJH.

- Njohja e Gjuhës së huaj në të cilën punoj.
- Njohja e tipareve kulturore të vëndasve të asaj gjuhe.
- Njohja e historisë së vendit.

Këto janë 3 nga pikat kryesore pasi bëjnë të mundur të mikpritjen, shmangien e përplasjeve të kulturave dhe gjetjes së mënyrës së saktë për të përcjellë informacionin.

Në organizimin e Kurrikulave në mënyrë të atillë që të aftësojnë studentët sa më shumë (megjithëse një pjesë e tyre studiohen që në gjimnaz) do ishin:

- 1- Historia e zhvillimit të njerëzimit.
- 2- Historia e Artit (etapat edhe elementët e ndryshme të llojeve të artit.)
- 3- Historia e Shqipërisë (megjithëse supozohet më herët, mbetet shumë sipërfaqësore. Çdo informacion me të cilin duhet të pajiset guida duhet të jetë zyrtar dhe i konfirmuar zyrtarisht.)
- 4- Njohja e siteve të ndryshme kulturore shqiptare dhe pajisja me informacionin e duhur për secilin



sit. (Në të njëjën mënyrë sic udhëtojnë studentët nga degët e gjeografisë, arkeologjisë për të parë terrenin ashtu mund të organizohen dhe udhëtimet e studentëve të turizmit).

- 5- Njohja me anë ligjore dhe morale: Detyrimet, përgjegjësitë dhe kodi i etikës së udhërrëfyesit turistik.
- 6- Njohuritë dhe aftësitë profesionale plus aftësitë e biznesit (përgatitja e programeve turistike dhe aftësia në shitjen e tyre).*)

E gjithë kjo shumë informacionesh mund të shoqërohet apo kërkohet për t'u përkthyer nga vetë studentët në gjuhën që ata do të operojnë në turizëm. Personalisht, studimet në degën e përkthimit më kanë ndihmuar më së miri për të transmetuar informacionin sa më mirë të jetë e mundur tek turistët. Duke qenë se herë pas herë, në mënyra krejt të paplanifikuara më ka ndodhur të përkthej nje arkeolog i cili përdor terma të fushës që nuk i njoh, kam ndjerë nevojën që informacionet që kam mësuar ti kisha marrë në gjuhën në të cilën punoj.

Të gjitha këto pika më lart i konsideroj të domosdoshme për t'u studjuar sidoqoftë ndarja që do të bëjë më pas studenti terren apo sektorë të tjerë. Kjo pasi udhëtimet e vazhdueshme duke shoqëruar turista për disa janë të pamundura.

Për sa i përket pikës së fundit 6* (punë operative në zyra), bëhet aftësimi i studentëve në njohuritë e përgjithshme që mund ti zbatojë në hartimin e paketave turistike brenda dhe jashtë vendit si psh:

- Njohja e pikave turistike
- Njohja e distancës
- Njohja e kohës në të cilën sugjerohet të bëhet një udhëtim.
- Njohja e llojit të udhëtimit (detar, malor, kulturorohistorik, arkeologjik, agroturizëm etj.)
- Njohja e kategorisë së objekteve akomoduese.

Tranjimi që kam bërë për të marrë licensën ka qënë një trajnim intensiv i cili bashkë me ekspeditat për mua zgjati 13.5 javë. 180 orë teori dhe 156 praktikë. Po e shtoj këtë informacion në rast se duhet krahasuar volumni i sugjerimve që kam bërë, me kohën në të cilën mund të konkretizohet në praktikë.



8. Bibliografia

- Studim i Tregut të Punës për Studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, dhjetor 2021
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023, burimi zyrtar në ëeb me URL: <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>
- World Travel and Tourism Council, burimi zyrtar në ëeb me URL: <http://knoema.com/ETTC2019/world-travel-and-tourism-council-data>
- INSTAT, burimi zyrtar në web me URL: <http://www.instat.gov.al/media/5529/turizmi-ne-shifra.pdf>
- Ministria e Turizmit, Lista e Udhërrëfyesve Turistikë të Çertifikuar me Kategorinë "Kombëtar", burimi zyrtar në ëeb me URL: <http://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/Lista-e-udh%C3%ABrr%C3%ABfyesve-kategoria-KOMBETAR.pdf>
- Pyetësor ndaj Agjencive Turistike, ideuar, realizuar dhe analizuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Rezultatet ruhen në formatin excel në database të FGJH-së.
- Pyetësor ndaj Studentëve të Diplomuar në FGJH 2018-2021, ideuar, realizuar dhe analizuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Rezultatet e këtij pyetësori gjenden në ambientin Office365 sipas URL: https://forms.office.com/Pages/DesignPage.aspx?lang=en-US&origin=OfficeDotCom&route=Start#Analysis=true&FormId=NhkHq6jtTEibPfvSHb0IJhrRcuEë-0xBqR_o11jtxlFUN1ISQVVUSFVYMVBUOTVTUIJSSUFJMTFOVC4u
- Lista e përkthyesve të jashtëm me certifikatë sigurie dha pa certifikatë, nga Ministria e Drejtësisë sipas URL: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/Lista-e-perditesuar-e-perkthyesve-zyrtare-per-vitin-2021.pdf>

Miratoi:

DEKANI

Prof. Dr. Esmeralda KRUMIDHA

